



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 172, Datë 29.08.2024

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 102, DATË 27.05.2024

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nën pikës 3.5 të pikës 3 “Të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 3 pika 8 të Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 06.03.2020; Kreu B.4 “Detyrimet e palëve”, gërma B.4.5.6. të “Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregutit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar; neneve 15 dhe 21 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës” të datës 21.10.2021, nënshkruar nga ERE, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) sh.a. dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) sh.a.; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.08.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1836 prot., datë 28.08.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 287, datë 09.10.2023 “Mbi propozimin për miratimin e Metodologjisë për Përcaktimin e Strukturës së Tarifave në AlpeX dhe Miratimin e Listës së Tarifave”, i ndryshuar, si dhe vendimin e bordit të ERE-s nr. 102, datë 27.05.2024 “Mbi Miratimin e Listës së Tarifave të ALPEX për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 287, datë 09.10.2023, miratoi listën e tarifave të ALPEX të cilat do jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri më 31.03.2024 si dhe filloi procedurën për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifave” të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), mbështetur në konstatimet e këtij vendimi.
- ERE me vendimin e bordit nr. 50, datë 02.04.2024, vendosi shtyrjen e afatit të aplikimit të “Listës së Tarifave të ALPEX” për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri më 31.08.2024, si pasojë e kërkesës së shoqërisë ALPEX sh.a. me argumentin

se metodologjia për përcaktimin e strukturës së Tarifave të ALPEX është ende në proces shqyrtimi.

- Gjithashtu, bazuar në kërkesën e shoqërisë ALPEX sh.a. për miratimin e Listës së Tarifave në rolin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), në kuadër të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë, bordi i ERE-s me vendimin nr. 102, datë 27.05.2024, vendosi miratimin e pjeshëm të kërkesës së paraqitur nga shoqëria ALPEX sh.a. për “Listën e Tarifave për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë”. Referuar këtij vendimi, afati i aplikimit të këtyre tarifave për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) gjithashtu përfundon më 31.08.2024.
- Metodologjia për përcaktimin e tarifave për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), e përcjellë në ERE nga shoqëria ALPEX sh.a., është propozuar për miratim edhe pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës – ZrRE, në zbatim të nenit 6, pikave 6.1 dhe 6.4 të “Marrëveshjes Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”, të datës 21 tetor 2021. Meqenëse metodologjia është ende në proces shqyrtimi nga rregullatorët e të dy vendeve, vlerësohet e nevojshme që tarifat e miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 102, datë 27.05.2024 të qëndrojnë në fuqi deri më datë 31.12.2024, me qëllim garantimin e vijimit të ushtrimit të funksioneve operacionale të ALPEX sh.a. deri në finalizimin e procesit të miratimit të “Metodologjisë së përcaktimit të tarifave” të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. “*Lista e Tarifave për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë*”, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 102, datë 27.05.2024 do jetë e aplikueshme deri me 31.12.2024 për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojnë shoqërinë AlpeX sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI